



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 61/09

Prishtinë, më 7.10.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Armend Zemaj, Müfera Şinik, dhe Hajdin Abazi.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Riza Smaka dhe Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurie Canolli.**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Dino Hasanaj – Kryetar i Bordit të AKP-së, Naim Avdiu dhe Shkumbin Bicaj nga AKP, Mehdi Geci, Sevdail Kastrati nga KPMK, pjesëmarrës nga GTZ, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

Kryesues: Armend Zemaj, Anëtar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 09.09.2009 dhe 16.09.2009;**
- 3. Dhënia e sqarimeve nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave lidhur me miratimin e Nivelit të pagave të personelit të Autoritetit të Aviacionit Civil
I ftuar: z. Ahmet Shala, Ministër i MEF-it;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën Gusht 2008 – Gusht 2009
I ftuar : Dino Asanaj , Kryetar i Bordit të drejtoreve i AKP-së;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit nr.03/2686/Ra-016/2 ,dt. 18.09.2009 financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008
I ftuar : Mehdi Geci , Kryetar i KPMK-së;**
- 6. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, në mungesë të Ministrit të MEF-it, propozoi që pika e tretë e rendit të ditës, të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Rendit ditës miratohet me ndryshime. Pika e tretë e rendit të ditës shtyhet për në mbledhjen e radhës, ndërsa në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 09.09.2009 dhe 16.09.2009

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi përgatitjen e mirë të procesverbaleve.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbalet nga mbledhja e kaluar dt. 09.09.2009 dhe 16.09.2009, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën Gusht 2008 – Gusht 2009

Kryesuesi, për të dhënë informacione më të shumta për raportin ia, dha fjalën kryetarit të bordit të AKP-së.

Dino Hasanaj, theksoi se kemi të bëjmë me një raport pune të AKP-së për periudhat e caktuara. Në bazë të kërkesës së disa deputetëve dhe për hirë të transparencës dhe njoftimit të opinionit kemi dorëzuar këtë raport në Kuvend. Raporti përmbledh aktivitetet e AKP-së për periudhën e caktuar. Ndërsa sa i përket pasqyrave financiare është bërë vetëm një prezantim i shkurtër i tyre për periudhën e vitit 2008, për arsye se të njëjtat janë dorëzuar Kuvendit në raportin e AKP-së për vitin 2008. Ndërkaq për periudhën janar - gusht 2009, nuk i kemi prezantuar pasqyrat financiare, të njëjtat do të dorëzohen në kohën e paraparë me ligj.

Myrvete Pantina, vlerësoi raportin gjithëpërfshirës. Megjithëse pjesa financiare nuk është prezantuar siç kërkohet me ligj. Shfaqja shpresën se në dorëzimin e raportit vjetor do të plotësohet edhe kjo pjesë, ku do të jepeshin të dhëna më të detalizuara. Sa i përket pjesës tjetër të raportit, kërkoi që të insistohet që BQK-ja të raportojë me shkrim për gjendjen e mjeteve të privatizimit. Lidhur shpërndarjen e 20% për punëtorët, theksoi se shumica e ndarë prej 16 milion € është e vogël, në krahasim me shumën totale që është paraparë prej 76€. Për çështjen e djegies së dokumentacionit të AKM-së, kërkoi që të insistohet në gjetjen e kryerësve të kësaj veprë. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore që janë të uzurpuara, po shkakton probleme të caktuara. Pyeti a keni menduar që këto prona më parë të lirohen nga uzurpimet e mëpastaj të shiten? Gjithashtu u interesua të dinte se kur do të privatizohet “Brezovica”, kur dihet se privatizimi i saj është në interes të përgjithshëm dhe sjell përfitime të mëdha.

Kosara Nikolić, theksoi se ka informacione që tokat bujqësore që janë shitur, iu është ndryshuar ridedstinimi. Lidhur me këtë pyeti qfarë mund të bëjë agjencion në këtë drejtim? Gjithashtu u interesua të dinte pse një numër i madhë punëtorësh nuk janë përfshirë në listën e 20% ?

Besa Gaxherri, vlerësoi raportin gjithëpërfshirës. Nga raporti shifet se procesi i privatizimit po ballafaqohet me probleme të caktuara. Rasti i neglizhencës së Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, që po zvarritet procesin në zgjidhjen e lëndëve të parashtruara para saj. Në këtë drejtim pyeti se a keni përcaktuar kufijtë se deri kur mund të zvarritet ky proces? Ndërsa për dokumentacionin e djegur të AKM-së, pyeti a keni bërë ndonjë padi për tu ndriçuar rasti? Po ashtu preku edhe çështjen e pronave shoqërore të uzurpuara, dhe u interesua të dinte nëse agjencionin ka bërë ndonjë plan konkret

me gjykatat, që me rastin e shitjes së këtyre pronave, blerësi të mos ketë probleme në shfrytëzimin e tyre.

Kryesuesi, diskutoi për rëndësinë e procesit të likuidimit dhe ndërmarrjet publike që kanë kreditor. Përmendi rastin e administratës tatimore, ndaj të cilës ndërmarrje publike kanë borxhe dhe e rrit shkallën e obligimeve të tyre. Lidhur me këtë çështje, pyeti sa agjencia ka mundur ti qaset këtij problemi ndaj atyre që nuk i kanë kryer obligimet ndaj ATK-së?

Dino Hasanaj, në pyetjen e parashtruar për BQK-në, theksoi se kemi marrë përgjigjen se mjetet e privatizimit janë të sigurta, dhe jemi në pritje të konfirmimit me shkrim. Për efikasitetin më të madh të Odës së Veçantë, nuk është kompetencë e agjencisë të intereferojë në punët e gjyqësorit. Shpërndarja e 20% ka shënuar progres duke analizuar situatën si ka qenë në agjencionin e mëparshëm (neglizhencën, pengesat teknike). Për djegien e dokumentacionit mbetet për të verifikuar ato që në janë dërguar në formë elektronike. Rasti i privatizimit të Brezovicës është delikatë. Për shkak të kompleksiteti dhe rëndësisë së këtij aseti, është menduar që në bashkëpunim me partnerët evropian të organizohet një konferencë ndërkombëtare. Në pyetjen për tokat bujqësore të privatizuara, me ligj është e përcaktuar se komunat janë kompetente për të vendosur për destinimin e tyre. Me qëllim të përshpejtimit të procedurave në procesin e privatizimit dhe eliminimin e pengesave ligjore në dinamizmin e punëve të AKP-së, kemi sugjeruar ndryshimin e rregulloreve dhe ligjit në fuqi.

Shkumbin Bicaj, përmendi vonesat që po shkakton Oda e Veçantë e Gjykatës së Supreme në procesin e shqyrtimit të ankesave dhe në shpërndarjen e 20%. Në këtë drejtim është e nevojshme që të nxirret Ligji i ri për këtë organ, gjë që është përcaktuar edhe me Pakon e Ahtisarit. Sa i përket problemeve me pronat e privatizuara, agjencia në bazë të ligjit është e obliguar të privatizojë ato, pas nënshkrimit të kontratës, pala të drejtën mund të kërkojë në gjykata. Në këto raste agjencia mund të paraqitet dëshmitare për palën.

Besa Gaxherri, theksoi se propozim-amendamentet konkrete për ndryshimin e rregulloreve dhe ligjit mund të dërgohen në Komisioni, të cilat do ti shqyrtojë dhe procedojë për aprovim në Kuvend.

Haki Shatri, propozoi që në rekomandimin e Komisionit për Kuvendin, të kërkohej nga Qeveria të përshpejtojë procedurat e hartimit dhe dorëzimit në Kuvend të Ligjit për Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni shqyrtoi Raportin i punës së Agjencionit Kosovar të Privatizimit për periudhën e përfunduar Gusht 2008- Gusht 2009, dhe konstatoi se pjesa financiare për periudhën Gusht 2008 është shqyrtuar me dt. 15qershor 2009, dhe iu është rekomanduar Kuvendit të njëjtin ta miratojë. Raporti për periudhën Gusht 2009 nuk përmban pasqyrat financiare për këtë periudhë.
- II. Me qëllim të përshpejtimit të procedurave në shqyrtimin e ankesave dhe padive të kreditorëve dhe punëtorëve nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme, dhe sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për vendosjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007, Komisioni i propozon Kuvendit të së Kosovës, që të kërkojë nga Qeveria e Kosovës të përshpejtojë procedurat e hartimit dhe dorëzimit në Kuvend të Ligjit për Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme.

4. Shqyrtimi i Raportit nr.03/2686/Ra-016/2 ,dt. 18.09.2009 financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008

Kryesuesi, për të dhënë informacione më të shumta për raportin në fjalë, ia dha fjalën kryetarit të KPMK-së.

Mehdi Geci, theksoi se pasi që nuk ka qenë pjesë e Këshillit në vitin 2008, për të dhënë informacione për këtë raport ia kaloi fjalën ish kryetarit të KPMK-së, z. Sevdail Kastrati.

Sevdail Kastrati, njoftoi se pasiqë buxheti i KPMK-së është pjesë e buxhetit të Kuvendit (me vijë të veqnat buxhetore), secila procedurë financiare është kryer me inicim të Këshillit, dhe me mbulesën buxhetore dhe administrative të Kuvendit. Edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në auditmin e saj nuk ka dhënë vërejtje për pasqyrat financiare të KPMK-së.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që në seancën plenare, të miratojë Raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për vitin 2008.

5. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Kryesuesi, njoftoi se grupi punues i komisionit, bashkarisht me ekspertin e USAID-it, përfaqësuesit ATK-së, në disa takimeve të mbajtura kanë shqyrtuar projektligjin dhe kanë bërë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme, dhe komisionit i kanë paraqitur propozim-amendamentet për aprovim.

Kosara Nikolić, theksoi se për shkak të marrjes me vonesë të materialit, në kanë mundur që në grupin parlamentar ti analizojnë këto propozim-amendamente. Megjithatë vlerësoi se amendamenti 7 që ndryshon nenin 4.2, është i panevojshëm këtu, sepse të drejtat in rem janë të rregulluara me Ligjin për të drejtat sendore.

Kryesuesi, në përgjigjen e parafolëses, theksoi se për të drejtat in rem është dhënë përkufizimi i tyre dhe ato janë përfshirë në këtë ligj për qëllime të TVSH-së.

Hajdin Abazi, theksoi se mbështet në parim aprovimin e këtyre propozim-amendamenteve, por se ka nevojë që të bëhet rregullimi i tyre në aspektin gjuhësor.

Pasi vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për, asnjë Kundër dhe një Abstenim (znj. Kosara Nikolić) nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohen propozim – amendamentet e grupit punues për Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.
- II. Raporti me amendamente procedohet në procedurë të mëtutjeshme për miratim në Kuvend.

6. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi anëtarët për seminarin që do ta organizojë GTZ-ja, me ekspertët që do të vijnë nga Gjermani. I njëjti është caktuar më datat 12-13 tetor.

Safete Hadërgjonaj, njoftoi se në datat e lartcekura (12-13 tetor), janë caktuar seancat e radhës plenare. Prandaj këto dy ditë nuk do të mund të mbahet seminari.

Besa Gaxherri, duke ditur rëndësinë e këtyre seminareve, propozoi që ato të planifikohen që të mbahen, pas fushatës zgjedhore.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, anëtarët u akorduan që seminari i organizuar nga GTZ, të mbahet më 14 tetor 2009.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Armend ZEMAJ